

Komisioni i Auditimit i KRU. "Hidromorava"- SH.A. Gjilan, i emëruar sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.09/67 të dt. 09.03.2022, si dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për emërimin e Komisionit të Auditimit në KRU. "Hidromorava" - Sh.A, nr. 201 të datës 22.01.2025, gjatë mbledhjes së dytë të rregullt të mbajtur më datë 28.02.2025, duke u bazuar në kompetencat sipas dispozitave ligjore të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, neni 21 që përcakton kompetencën e Komisionit të Auditimit, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

**I. z. Avdyl Kastrati** emërohet në pozitën: **Zyrtar për Auditim të Brendshëm**, në KRU. "Hidromorava"-SH.A., Gjilan.

**II.** I emëruari sipas pikës I. të këtij vendimi do të fillojë punën me efekt nga data 01.04.2025, ku do të lidhet kontrata e punësimit me përshkrimin e marrëdhënies së punës, detyrave dhe përgjegjësiive për këtë pozitë.

## A r s y e t i m

Komisioni i Auditimit i KRU. "Hidromorava" - Sh.A., Gjilan, ka zhvilluar procedurat e rekrutimit sipas Konkursit Publik (Rishpallje e Konkursit) me nr. referencës 1838 i publikuar me datë 31.12.2024 për pozitën Zyrtar për Auditim të Brendshëm në KRU. "Hidromorava" - SH.A. Gjilan. Komisioni i Auditimit ka përfunduar me sukses procedurën e rekrutimit dhe vlerësimit dhe me vendimin nr. 134 të dt. 13.02.2025 ka përzgjedhur kandidatin e sukseshëm, z.Avdyl Kastrati për pozitën zyrtar për Auditim të Brendshëm në KRU. "Hidromorava" - Sh.A. Gjilan. Me këtë vendim është përcaktuar edhe e drejta e ankesës nga kandidatët e pakënaqur me këtë proces.

Pas përfundimit të periudhës së ankesave, janë krijuar kushtet ligjore duke i dhënë të drejtë kandidatit të përzgjedhur emërimin në pozitën Zyrtar për Auditim të Brendshëm dhe lidhjen e kontratës së punës me përshkrimin e detyrave të punës.

Prandaj, Komisioni i Auditimit pas krijimit të kushteve ligjore dhe përmbylljes me sukses të procesit të rekrutimit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e ankimimit në Gjykatën Themelore në Gjilan.

Gjilan,  
Datë:28.02.2025

Komisioni i Auditimit  
  
znj. Ferdane Tahiri Sylejmani  
Kryesuese e Komisionit të Auditimit